

Në bazë të nenit 18 paragrafi (7) të Ligjit të Borxhit Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.62/05, 88/08, 35/11, 139/14 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.98/19 dhe 151/21), ministri i Financave miraton

Rregullore për mënyrën dhe procedurën e emetimit dhe pagesës së letrave shtetërore me vlerë në tregun e brendshëm financiar

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe procedurën e emetimit dhe pagesës së letrave shtetërore me vlerë në tregun e brendshëm financiar (në tekstin e mëtejshëm: letrat shtetërore me vlerë).

Neni 2

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë këtë domethënie:

- 1. Letër shtetërore me vlerë** do të thotë letër me vlerë debitore afatshkurtër ose afatgjate, e emetuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut për mbledhjen e mjeteve financiare dhe mund të ketë emërtim specifik të caktuar nga emetuesi.
- 2. Bono shtetërore** është letra me vlerë debitore me afat maturimi më të shkurtër se një vit kalendarik nga dita e emetimit, që emetohet nga Republika e Maqedonisë së Veriut për mbledhjen e mjeteve financiare.
- 3. Fletobligacion shtetëror** është letër me vlerë debitore me afat maturimi më të gjatë se një vit kalendarik nga dita e emetimit, që emetohet nga Republika e Maqedonisë së Veriut për mbledhjen e mjeteve financiare.
- 4. Emetuese** është Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar përmes Ministrisë së Financave.
- 5. Agjente** është Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- 6. Pjesëmarrës i autorizuar direkt** është bankë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila mund të blejë dhe të shesë letra shtetërore me vlerë për llogari të saj ose për llogari të pjesëmarrësve indirekt dhe që ka lidhur marrëveshje për pjesëmarrje në tregun primar të letrave shtetërore me vlerë.
- 7. Pjesëmarrës indirekt** është person juridik ose fizik, i cili blen letra shtetërore me vlerë përmes pjesëmarrësit të autorizuar direkt.
- 8. Regjistër** është Depozitari Qendror i Letrave Shtetërore me Vlerë.

- 9. Sistem elektronik** është sistem elektronik për operacione tregtare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes të cilit realizohen ankandet e letrave shtetërore me vlerë.
- 10. Kalendar** është skemë e publikuar paraprake e ankandëve të planifikuara të letrave shtetërore me vlerë.
- 11. Ankand** është teknikë e emetimit të letrave shtetërore me vlerë, me ç'rast pjesëmarrësit e autorizuar direkt i dërgojnë agjentit oferta për blerjen e letrave shtetërore me vlerë dhe pranimin e tyre nga emetuesi.
- 12. Çmim** paraqet çmimin e blerjes së letrave shtetërore me vlerë, respektivisht çmimin e shitjes së tyre, të shprehur zakonisht për 100 njësi monetare të letrës me vlerë.
- 13. Ofertë jokonkurrese** është ofertë për blerjen e letrave shtetërore me vlerë, ku ankandohet vetëm me vlerë, ndërsa çmimi është i barasvlefshëm me çmimin e ponderuar (mesatar) (normë interesi) të arritur në ankand.
- 14. Rregull i pjesëmarrjes së limituar** është kufizimi i vlerës së ankanduar për çdo pjesëmarrës individual në ankand (pjesëmarrës i autorizuar direkt ose pjesëmarrës indirekt) i cili nuk mund ta tejkalojë përqindjen e caktuar të vlerës së ofruar në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.
- 15. Shenjë ISIN (ISIN – International Securities Identification Number)** është kodi i identifikimit ndërkombëtar, i cili u caktohet letrave me vlerë të emetuara në tregjet financiare.
- 16. Ditë pune** është çdo ditë e punës në Sistemin e pagesave ndërbankare të Maqedonisë (SPNM) i vendosur në përputhje me ligjin.
- 17. Libër i poseduesve të letrave shtetërore me vlerë** është libri i të dhënave për gjendjen e zotërimit të poseduesve të letrave shtetërore me vlerë.

Neni 3

Letrat shtetërore me vlerë emetohen në valutë vendase me ose pa klauzolë devizore dhe mbahen si shënime elektronike në regjistër.

Neni 4

Bonot shtetërore emetohen dhe paguhen me vlerë nominale dhe shiten në tregun primar me vlerë diskonte.

Fletobligacionet shtetërore emetohen dhe paguhen me vlerë nominale dhe shiten në tregun primar me çmimin e arritur në ankand dhe kanë interes kuponi gjysmëvjetor ose vjetor deri në maturim.

II. PJESMARRËSIT NË TREGUN PRIMAR

1. Emetues i letrave shtetërore me vlerë

Neni 5

Emetuesi përcakton vlerën e çdo emetimi të letrave shtetërore me vlerë, të cilat shiten me ankand.

Emetuesi para çdo emetimi, vendos lidhur me atë nëse emetimi i letrave shtetërore me vlerë në valutën vendase do të jetë me ose pa klauzolë devizore.

Gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, emetuesi vendos nëse letrat me vlerë shtetërore do t'u ofrohen personave juridikë dhe/ose personave fizikë në tregun primar.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt në ankandin e letrave shtetërore me vlerë në tregun primar duhet të mundësojnë që të marrin pjesë vetëm subjektet e cituara në prospekt.

Gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, emetuesi jep sqarime për letrat shtetërore me vlerë me anë të fusnotës në prospektin e publikuar në faqen e tij të internetit.

Krahas detyrave nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (5) të këtij neni, emetuesi kryen edhe detyra vijuese:

- përgatitjen dhe publikimin e kalendarit;
- mirëmbajtjen e qasjes funksionale në sistemin elektronik;
- përcaktimin dhe publikimin e prospektit për çdo emetim;
- përcaktimin e interesit të kuponit nëse fletobligacionet shtetërore shiten me kupon të paracaktuar;
- autorizimin dhe publikimin e rezultateve të ankandit të mbajtur;
- verifikimin e pagesës së letrave shtetërore me vlerë të blera;
- dorëzimin e autorizimit të agjentit për regjistrimin e pronësisë së letrave shtetërore me vlerë, të fituara në tregun primar;
- pagesën e letrave shtetërore me vlerë;
- pagesën e kuponëve të fletobligacioneve shtetërore dhe
- monitorimin e tregimit të letrave shtetërore me vlerë në tregun sekondar.

Emetuesi informon publikun në faqen e tij të internetit për kalendarin në fillim të periudhës së cilës i referohet.

Emetuesi informon publikun në faqen e tij të internetit për çdo emetim të letrave shtetërore me vlerë, si dhe për rezultatet e tij.

Ndërmjetësuesit tregtarë dhe tregjet e institucionalizuara njoftojnë emetuesin dhe agjentin në bazë ditore për transaksionet e kryera me letrat shtetërore me vlerë në tregjet e institucionalizuara dhe jashtë tregjeve të institucionalizuara, në formularë përkatës.

2. Agjent për emetimin e letrave shtetërore me vlerë

Neni 6

Emetuesi dhe agjenti i rregullojnë në mënyrë të ndërsjellë marrëdhëniet në lidhje me emetimin e letrave shtetërore me vlerë.

Neni 7

Agjenti në lidhje me emetimin e letrave shtetërore me vlerë:

- krijon, mirëmban dhe me kërkesë të emetuesit, përmirëson sistemin elektronik të mbajtjes së ankandeve;
- organizon ankande të letrave shtetërore me vlerë;
- mbledh të dhëna për posedimin e letrave shtetërore me vlerë nga pjesëmarrësit e autorizuar direkt;
- dorëzon të dhëna në regjistër për emetimin (normën e interesit të kuponit dhe datat e pagesës së kuponit) dhe për posedimin e letrave shtetërore me vlerë.

3. Pjesëmarrësit e autorizuar direkt

Neni 8

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt me emetuesin dhe agjentin i rregullojnë në mënyrë të ndërsjellë marrëdhëniet në lidhje me emetimin e letrave shtetërore me vlerë.

Neni 9

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt marrin pjesë drejtpërdrejt në një ankand të letrave me vlerë të qeverisë.

Neni 10

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt vendosin lidhje komunikimi me sistemin elektronik.

Neni 11

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt kryejnë punët që kanë të bëjnë me:

- mirëmbajtjen e qasjes funksionale në sistemin elektronik;
- informimin e pjesëmarrësve indirekt për kushtet e emetimit;
- mbledhjen e kërkesave nga pjesëmarrësit indirekt;
- dorëzimin e ofertave tek agjenti ose tek emetuesi nëse kjo është parapërcaktuar në prospekt. Në këtë rast, ofertat dorëzohen në formë elektronike;
- informimin e pjesëmarrësve indirekt për rezultatet e ankandit të letrave shtetërore me vlerë;

- dorëzimin e të dhënave për pjesëmarrësit indirekt me oferta të suksesshme pas përfundimit të ankandit sipas nenit 48, përkatësisht 49 të kësaj rregulloreje, si dhe dorëzimin e secilës së dhëne tjetër për të cilën është rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë;
- pagesën e vlerës së letrave shtetërore me vlerë të blera në llogarinë e emetuesit dhe
- dorëzimin e autorizimit për të debituar llogarinë te agjenti.

4. Pjesëmarrësit indirekt

Neni 12

Pjesëmarrësi indirekt është rezident dhe/ose jorezident.

Pjesëmarrësit indirekt dhe pjesëmarrësit e autorizuar direkt i rregullojnë marrëdhëniet në mënyrë të ndërsjellë lidhur me letrat shtetërore me vlerë.

III. EMETIM I LETRAVE SHETËRORE ME VLERË

Neni 13

Emetimi i letrave shtetërore me vlerë përfshin shitjen initiale të letrave shtetërore me vlerë nga emetuesi dhe regjistrimin e tyre.

Shitja initiale kryhet nëpërmjet realizimit të ankandeve, ndërsa mjetet financiare të grumbulluara janë në dispozicion të emetuesit.

Përrjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë letrat shtetërore me vlerë që emetohen për qëllime të tjera, në funksion të politikës monetare, të përcaktuara dhe të rregulluara në mënyrë shtesë nga emetuesi.

Shitja initiale konsiderohet si përfundimtare me regjistrimin e letrave shtetërore me vlerë në regjistër, në llogaritë e zotëruesve (poseduesve).

1. Organizim i ankandit të letrave shtetërore me vlerë

Neni 14

Ankandet realizohen përmes sistemit elektronik të zhvillimit të ankandeve, në të cilin qasje kanë vetëm agjenti, emetuesi dhe pjesëmarrësit e autorizuar direkt.

Për mënyrën e lidhjes me lokacionin primar dhe atë rezervë, emetuesi dhe pjesëmarrësit e autorizuar direkt marrin "Instruksione teknike për mënyrën e lidhjes në sistemin elektronik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Qasja e emetuesit dhe pjesëmarrësve direkt të autorizuar kontrollohet, me ç'rast kontrolli është kompleks dhe përbëhet nga disa aspekte:

- lidhja e emetuesit dhe pjesëmarrësve të autorizuar direkt të ankandeve është krijuar sipas Vendimit për lidhje me sistemin informativ të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe

- çdo përpjekje për qasje të paautorizuar në sistemin elektronik refuzohet dhe evidentohet nga agjenti.

Mënyra e përdorimit të sistemit elektronik është përshkruar hollësisht në “Udhëzimet teknike të punës me letra shtetërore me vlerë përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për agjentin”, “Udhëzimet teknike të punës me letra shtetërore me vlerë përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për emetuesin” dhe “Udhëzimet teknike të punës me letra shtetërore me vlerë përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore për pjesëmarrësin direkt të autorizuar”

1.1 Prospekt për ankandin e letrave shtetërore me vlerë

Neni 15

Ankandet e letrave shtetërore me vlerë realizohen sipas datave të mbajtjes së tyre, të përcaktuara në kalendar.

Neni 16

Emetuesi i letrave shtetërore me vlerë gjatë realizimit të ankandëve mund të shfrytëzojë:

- tender me norma interesi [tender me çmime të shumëfishta (lloji amerikan) dhe tender me çmim të njësuar (lloji holandez)] ose
- tender me vlera.

Neni 17

Emetuesi përcakton dy lloje prospektesh: prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.

Emetuesi përcakton prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore dhe ia dorëzon ato agjentit përmes sistemit elektronik deri në orën 14:00 në ditë pune apo më së voni katër ditë pune para ditës së mbajtjes së ankandit.

Në orën 14:30 të ditës së njëjtë, agjenti i dërgon prospektet nga paragrafi (2) i këtij neni, për të gjithë pjesëmarrësit e autorizuar direkt përmes sistemit elektronik.

Neni 18

Në prospektin e ankandit të bonove shtetërore përcaktohen kushtet vijuese për pjesëmarrje në ankand:

- data e mbajtjes së ankandit;
- koha e mbajtjes së ankandit dhe koha e pranimit të ofertave për pjesëmarrje në ankand;
- lloji i tenderit për realizimin e ankandit;
- kodi i ankandit në një nga formatet vijuese është DZYYYY/N-D ose DZYYYY/N-Ddk;
- shkurtesa DZ, tregon se bëhet fjalë për bono shtetërore;
- numrat YYYY, tregojnë vitin kur janë emetuar bonot;
- te vendi i shkronjës N, vendoset numri rendor i ankandit që do të mbahet në vitin aktual;

- te vendi i shkronjës D, vendoset numri i ditëve të maturimit të bonove shtetërore;
- shkurtesa dk në formatin DZYYYY/N-Ddk, tregon se bëhet fjalë për bono shtetërore me valutë vendase, me klauzolë devizore;
- shenja ISIN e bonos shtetërore;
- vlera nominale e bonove shtetërore, që ofrohet për shitje në ankand;
- me ose pa klauzolë devizore;
- afati i pagesës së bonove shtetërore, sipas ditëve të punës;
- data e pagesës së bonove shtetërore;
- llogaria e emetuesit për pagesën e bonove shtetërore;
- numri i ditëve të maturimit të bonove shtetërore;
- data e maturimit të bonove shtetërore;
- çmimi, përkatësisht norma e interesit me të cilën ofrohen bonot shtetërore gjatë tenderit sipas vlerave;
- pikë përqindja spekulative ose çmimi minimal, përkatësisht norma maksimale e interesit;
- përqindja e vlerës nominale të bonove shtetërore që do të shpërndahet për ofertat jo konkurruese, në rast se emetuesi vendos ta aprovojë shitjen e bonove shtetërore me kushte jo konkurruese;
- informacioni për mënyrën e regjistrimit të bonovo shtetërore sipas nenit 48 ose nenit 49 të kësaj rregulloreje;
- koha e pranimit të ofertave që pjesëmarrësit e autorizuar direkt i mbledhin në emër të pjesëmarrësve të autorizuar indirekt përpara mbajtjes së ankandit të bonove shtetërore me emërtim specifik;
- lloji i subjekteve që në tregun primar mund të marrin bono shtetërore me emërtim specifik;
- të dhëna për të drejtat që rezultojnë dhe i referohen bonove shtetërore me emërtim specifik dhe
- informacioni mbi mundësinë e blerjes së parakohshme të bonove shtetërore.

Në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore përcaktohen kushtet e vijuese për pjesëmarrje në ankand:

- data e mbajtjes së ankandit;
- koha e mbajtjes së ankandit dhe koha e pranimit të ofertave për pjesëmarrje në ankand;
- lloji i tenderit për realizimin e ankandit;
- kodi i ankandit në një nga formatet vijuese është DOYYYY/N-MMGG ose DOYYYY/N-MMGGdk:
- shkurtesa DO, tregon se bëhet fjalë për fletobligacione shtetërore;
- numrat YYYY, tregojnë vitin kur janë emetuar fletobligacionet shtetërore;
- te vendi i shkronjës N, vendoset numri rendor i ankandit që do të mbahet në vitin aktual;
- te vendi i shenjës MMGG, vendoset muaji dhe viti i maturimit të fletobligacioneve shtetërore;
- shkurtesa dk në formatin DOYYYY/N-MMGGdk, tregon se bëhet fjalë për fletobligacione shtetërore me valutë vendase, me klauzolë devizore;

- shenja ISIN e fletobligacionit shtetëror;
- vlera nominale e fletobligacioneve shtetërore, që ofrohet për shitje në ankand;
- me ose pa klauzolë devizore;
- norma e interesit të kuponit;
- numri i kuponëve në nivel vjetor;
- data e maturimit dhe pagesës së kuponit;
- afati i pagesës së fletobligacioneve shtetërore, sipas ditëve të punës;
- data e pagesës së fletobligacioneve shtetërore;
- llogaria e emetuesit për pagesën e fletobligacioneve shtetërore;
- numri i viteve të maturimit të fletobligacioneve shtetërore;
- data e maturimit të fletobligacioneve shtetërore;
- norma e interesit me të cilën ofrohen fletobligacionet shtetërore gjatë tenderit sipas vlerave;
- spekulative ose çmimi minimal, përkatësisht norma maksimale e interesit;
- përqindja e vlerës nominale të fletobligacioneve shtetërore që do të shpërndahet për ofertat jo konkurruese, në rast se emetuesi vendos ta miratojë shitjen e fletobligacioneve shtetërore me kushte jo konkurruese;
- informacioni për mënyrën e regjistrimit të fletobligacioneve shtetërore sipas nenit 48 ose nenit 49 të kësaj rregulloreje;
- koha e pranimit të ofertave që pjesëmarrësit direkt të autorizuar i mbledhin në emër të pjesëmarrësve indirekt përpara mbajtjes së ankandit të fletobligacioneve shtetërore me emërtim specifik;
- lloji i subjekteve që në tregun primar mund të marrin fletobligacione shtetërore me emërtim specifik;
- të dhëna për të drejtat që rezultojnë dhe i referohen fletobligacioneve shtetërore me emërtim specifik dhe
- informacioni lidhur me mundësinë e blerjes së parakohshme të fletobligacioneve shtetërore.

Neni 19

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt i njoftojnë pjesëmarrësit indirekt për emetimin e ardhshëm të letrave shtetërore me vlerë përmes kontaktit direkt, me shkrim, telefonit, faqes së internetit, etj.

1.2 Oferta për ankand të letrave shtetërore me vlerë

Neni 20

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt e paraqesin pjesëmarrjen e tyre në ankandet me oferta për blerjen e letrave shtetërore me vlerë përmes sistemit elektronik.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, pjesëmarrësit e autorizuar direkt tek agjenti dorëzojnë oferta përmes sistemit elektronik,

ndërsa tek emetuesi dorëzojnë ofertat përmes raportit përmbledhës të dorëzuar në mënyrë elektronike. Raporti përmbledhës, përveç të dhënave që i dorëzohen agjentit, përfshin edhe numrin e vetëm të identifikimit (numër ID) për çdo pjesëmarrës indirekt që lidhet me ofertat për blerjen e letrave shtetërore me vlerë nga pjesëmarrësit indirekt, si dhe vlera të shpërndara, të përcaktuara nga emetuesi.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt në ankand të letrave shtetërore me vlerë mund të parashtrajnë oferta në emrin e tyre dhe në llogarinë e tyre ose në emrin e tyre dhe në llogarinë e pjesëmarrësve indirekt.

Neni 21

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt mbledhin kërkesa nga pjesëmarrësit indirekt.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt mbajnë evidencë elektronike të kërkesave të pranuar.

Sipas kërkesës me shkrim të emetuesit ose agjentit, pjesëmarrësit e autorizuar direkt e dorëzojnë evidencën nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 22

Ofertat për pjesëmarrje në ankande, dorëzohen përmes sistemit elektronik gjatë kohës së pranimit të ofertave për pjesëmarrje në ankand, të përcaktuar në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.

Kur një pjesëmarrës direkt, individual, i autorizuar nuk mund ta/t'i dorëzojë ofertën/ofertat tek agjenti përmes sistemit elektronik për shkaqe teknike brenda afatit të caktuar në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore, nevojitet që oferta/ofertat të dorëzohet/dorëzohen në mënyrë elektronike, respektivisht me e-mail ose faks tek emetuesi brenda 15 minutave pas përfundimit të afatit për pranimin e ofertave për pjesëmarrje në ankand, pas njoftimit paraprak me telefon në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit Publik në Ministrinë e Financave.

Dokumenti me ofertën/ofertat e dorëzuar/a me faks duhet të përfshijë të dhënat në vijim:

1. Memorandumin e pjesëmarrësit të autorizuar direkt;
2. Informacionin nëse oferta është në emrin e tij dhe në llogarinë e tij ose në llogarinë e pjesëmarrësit indirekt;
3. Kodin e ankandit të letrave shtetërore me vlerë;
4. Shenjën ISIN të letrave shtetërore me vlerë;
5. Vlerën e ofertës;
6. Çmimin (normën e interesit) me të cilin ankandohet;
7. Nënshkrimin e personit të autorizuar dhe vulën e institucionit.

Neni 23

Çdo pjesëmarrës i autorizuar direkt mund të dorëzojë numër të pakufizuar ofertash për blerje në ankandet e letrave shtetërore me vlerë.

Për secilin pjesëmarrës indirekt dorëzohet ofertë e veçantë. Nëse një pjesëmarrës indirekt në kërkesë ka cekur disa çmime të ndryshme, për secilin çmim dorëzohet ofertë e veçantë.

Neni 24

Pjesëmarrësi i autorizuar direkt, nëse blen bono shtetërore, pas njoftimit paraprak se në llogarinë e kujt i blen ato, duhet të vendosë në sistemin elektronik, elementet e ofertës si në vijim:

- vlerën në denarë dhe
- çmimin e saktë me nga katër decimale për 100 njësi monetare me vlerë nominale, gjatë tenderit me norma interesi.

Formula e Çmimi:

$$P = 100 * \frac{1}{1 + \frac{R * n}{36,000}}$$

P=çmimi

R=norma vjetore e interesit (në %)

n=maturimi (numri i ditëve).

Gjatë llogaritjes së çmimit të bonove shtetërore, përdoret standardi aktual/360, domethënë numri kalendar i ditëve në muaj/360 ditë në vit.

Pjesëmarrësi i autorizuar direkt, nëse blen fletobligacione shtetërore, pas njoftimit paraprak se në llogarinë e kujt i blen ato, duhet t'i vendosë në sistemin elektronik elementët e mëposhtëm të ofertës:

- vlera në denarë dhe
- çmimi me saktësi prej 0.005 pikë përqindjeje, për 100 njësi monetare me vlerë nominale, gjatë tenderit me norma interesi.

Formula për çmimin bazë të fletobligacionit shtetëror që ka interes kuponi gjysmëvjetor ose vjetor:

$$P = \sum_{k=1}^n \frac{\frac{c}{t}}{\left(1 + \frac{R}{t}\right)^{\left(k - 1 + \frac{a}{e}\right)}} + \frac{N}{\left(1 + \frac{R}{t}\right)^{\left(n - 1 + \frac{a}{e}\right)}} - \left(\frac{c}{t} \times \frac{A}{e}\right)$$

Me çmim bazë nënkuptohet çmimi bruto i zvogëluar për interesin e përlogaritur (accrued) që shfaqet për shkak të mospërputhjes ndërmjet fillimit të periudhës së kuponit dhe pagesës së fletobligacioneve shtetërore. Në tregun primar, gjatë ankandit fillestar, çmimi bruto dhe ai bazë janë të njëjta.

P=çmimi

N=100 njësi monetare - vlera nominale

R=norma vjetore e rendimentit (në %)

t=numri i kuponëve në nivel vjetor

A=numri i ditëve që nga fillimi i periudhës së kuponit deri në ditën e pagesës së fletobligacionit shtetëror, nëse fillimi i periudhës së kuponit dhe pagesa e fletobligacioneve nuk janë në të njëjtën datë.

a= numri i ditëve të pagesës së fletobligacionit shtetëror deri në kuponin tjetër

n=numri i kuponëve të plotë nga pagesa deri në maturim

e=numri i ditëve në periudhën e kuponit në të cilën kryhet pagesa

c=interesi vjetor i kuponit (në %)

k= numri rendor i kuponëve.

Në rast të rihapjes së ankandit të letrave shtetërore me vlerë të pamaturuara, zbatohet formula e mëposhtme e çmimit bruto:

$$P = \sum_{k=1}^n \frac{\frac{c}{t}}{\left(1 + \frac{R}{t}\right)^{\left(k-1 + \frac{a}{c}\right)}} + \frac{N}{\left(1 + \frac{R}{t}\right)^{\left(n-1 + \frac{a}{c}\right)}}$$

P=çmimi

N=100 njësi monetare - vlera nominale

R=norma vjetore e rendimentit (në %)

t=numri i kuponëve në nivel vjetor

a= numri i ditëve që nga nevilizimi deri në kuponin tjetër

n=numri i kuponëve të plotë nga nevilizimi deri në maturim

e=numri i ditëve në periudhën e kuponit në të cilën ndodh nevilizimi

c=interesi vjetor i kuponit (në %)

k= numri rendor i kuponëve.

Çmimi bruto, i cili përlogaritet gjatë rihapjes së ankandit të letrave shtetërore me vlerë të pamaturuara, përfshin interesin e akumuluar nga fillimi i periudhës së kuponit në të cilën është kryer rihapja deri në ditën e pagesës së fletobligacioneve shtetërore të blera në ankandin e rihapur.

Kuponi është i barasvlefshëm për të gjitha periudhat e përlogaritjes deri në maturimin e fletobligacioneve shtetërore dhe përlogaritet sipas formulës:

$$C = N \times \frac{c}{t}$$

Në rast se periudha për të cilën paguhet interesi i kuponit është i ndryshëm nga periudha standarde e përlogaritjes së kuponit, do të zbatohet

formula e mëposhtme:

$$C = N \times \frac{c}{t} \times \frac{A}{e}$$

C=kuponi në vlerë absolute

N=kryegjëja

c=interesi vjetor i kuponit (në %)

t=numri i kuponëve në nivel vjetor

A=numri i ditëve nga fillimi i periudhës së kuponit deri në ditën e nivelizimit

e=numri i ditëve në periudhën e kuponit në të cilën ndodh nivelizimi.

Gjatë përlogaritjes së çmimit të fletobligacioneve shtetërore dhe kuponit përdoret standardi aktual, përkatësisht numri kalendarik i ditëve në muaj/numri kalendarik i ditëve në vit.

Neni 25

Pjesëmarrësi i autorizuar direkt mund ta revokojë ose ndryshojë ofertën vetëm gjatë kohës së pranimit të ofertave për pjesëmarrje në ankand, të përcaktuara në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.

Ofertat e dorëzuara janë të përvokueshme pas përfundimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 26

Në momentin e pranimit të ofertave për pjesëmarrje në ankand, të përcaktuara në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore, agjenti dhe emetuesi nuk kanë qasje në të dhënat e ofertave.

Agjenti dhe emetuesi sigurojnë fshehtësinë e kushteve të ofruara nga pjesëmarrësit në ankand.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt nuk kanë njohuri për ofertat e pjesëmarrësve të tjerë të autorizuar direkt.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt sigurojnë fshehtësinë e kushteve të ofruara nga pjesëmarrësit indirekt.

1.3 Rezultatet e ankandit të letrave shtetërore me vlerë

Neni 27

Pas përfundimit të afatit të pranimit të ofertave, sistemi elektronik në mënyrë programuese i klasifikon ofertat sipas radhës në rënie, duke filluar nga oferta me çmimin më të lartë deri tek oferta me çmimin më të ulët, ndërsa kryen ndarjen sipas parimeve të caktuara.

Neni 28

Gjatë tenderit me çmime të shumëfishta, letrat shtetërore me vlerë

shpërndahen sipas çmimit - normës së interesit nga ofertat e suksesshme të pjesëmarrësve.

Nëse ndodh që disa pjesëmarrës të ofrojnë çmimin – normën e interesit të njëjtë, ndërsa kërkesa totale tejkalon ofertën e emetuesit, ofertat me çmimin më të ulët të pranuar shpërndahen në proporcion me vlerën totale të ankandit të të gjitha ofertave për blerjen e letrave shtetërore me vlerë me çmim më të ulët të pranuar sipas parimit të shpërndarjes proporcionale të përcaktuar në nenin 32 të kësaj rregulloreje.

Neni 29

Gjatë tenderit me çmim të njësuar, letrat shtetërore me vlerë shpërndahen sipas çmimit më të ulët – normës së interesit më të lartë të ofertave të suksesshme të pjesëmarrësve.

Nëse ndodh që disa pjesëmarrës të ofrojnë çmim – normë interesi të njëjtë, ndërsa kërkesa totale tejkalon ofertën e emetuesit, ofertat me çmimin më të ulët të pranuar shpërndahen në proporcion me shumën totale të ankandit të të gjitha ofertave për blerjen e letrave shtetërore me vlerë me çmimin më të ulët të pranuar, sipas parimit të shpërndarjes proporcionale të përcaktuar në nenin 32 të kësaj rregulloreje.

Neni 30

Në rast të realizimit të tenderit sipas vlerave, kur kërkesa totale tejkalon ofertën, ofertat shpërndahen në proporcion me vlerën e ankandit për blerjen e letrave shtetërore me vlerë, në përputhje me parimin e shpërndarjes proporcionale të përcaktuar në nenin 32 të kësaj rregulloreje.

Neni 31

Gjatë përqindjes së përcaktuar të vlerës nominale të letrave shtetërore me vlerë të ofruara që do të shpërndahen në ofertat jokonkurruese, nëse vlera e ofertave jokonkurruese tejkalon vlerën e përcaktuar të shpërndarjes, ofertat jokonkurruese shpërndahen sipas parimit të shpërndarjes proporcionale të përcaktuar në nenin 32 të kësaj rregulloreje.

Në rast se kërkesa për oferta jokonkurruese është më e madhe se vlera e përcaktuar për oferta jokonkurruese në prospekt, ndërsa kërkesa për oferta konkurruese është më e vogël se vlera e përcaktuar për oferta konkurruese në prospekt, realizimi i ofertave konkurruese do të rritet në mënyrë që realizimi total (konkurruese dhe jo konkurruese) të mos tejkalojë vlerën totale të ofruar.

Në rast se kërkesa për oferta jokonkurruese është më e ulët se vlera e përcaktuar për oferta jokonkurruese në prospekt, ndërsa kërkesa për oferta konkurruese është më e madhe se vlera e përcaktuar për oferta konkurruese në prospekt, realizimi i ofertave konkurruese do të rritet në mënyrë që realizimi total (konkurruese dhe jo konkurruese) të mos tejkalojë vlerën totale të ofruar.

Neni 32

Formula për përllogaritjen e shpërndarjes proporcionale:

$$Ap = A * (V2 / V1)$$

Ap=pjesa e pranuar e ofertës së pjesëmarrësit të autorizuar direkt;
A=vlera e ankandit të pjesëmarrësit të autorizuar direkt;
V1= vlera e përgjithshme e ankandit nga të gjitha ofertat dhe
V2= vlera e përgjithshme që emetuesi do të pranojë nga të gjitha ofertat.

Nëse gjatë shpërndarjes proporcionale, si rezultat i rrumbullakimit matematikor të vlerave të shpërndara në 10.000 denarë, paraqitet nevoja e rritjes së vlerës së realizuar, emetuesi mund ta rrisë vlerën e realizuar në raport me vlerën e ofruar.

Në rast të tenderit sipas vlerave, si rezultat i rrumbullakimit matematikor, mund të përdoret metoda e përzgjedhjes së rastësishme ose metoda e prioritetit kohor për ofertën e dorëzuar të pjesëmarrësit.

Gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, emetuesi njofton agjentin dhe pjesëmarrësit e autorizuar direkt për mënyrën e shpërndarjes së ofertave, gjatë ditës së njëjtë të punës ose më së voni deri në ditën vijuese në orën 12.

Neni 33

Emetuesi mund t'i refuzojë ofertat nga pjesëmarrësit e autorizuar direkt, të cilat konsiderohen oferta spekulative.

Ofertë spekulative konsiderohet ajo ofertë ku çmimi i së cilës është më i ulët se çmimi mesatar për pikë përqindje spekulative, e publikuar në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.

Çmimi mesatar nga paragrafi 2, përlogaritet si vlerë e ponderuar e ofertave me çmimin më të ulët, të cilat përbëjnë gjysmën e vlerës së të gjitha ofertave në ankand.

Neni 34

Emetuesi mund ta emetojë vlerën e njëjtë ose çdo vlerë tjetër më të vogël ose më të madhe të letrave shtetërore me vlerë sesa nga ajo që është specifikuar në prospektin e ankandeve individuale (veçmas) të letrave shtetërore me vlerë.

Në fund të vitit fiskal, vlera neto e huamarrjes përmes letrave shtetërore me vlerë nuk duhet ta tejkalojë vlerën maksimale neto të huamarrjes, nëpërmjet letrave shtetërore me vlerë të përcaktuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Emetuesi mund ta emetojë vlerën e njëjtë ose çdo vlerë tjetër më të vogël të letrave shtetërore me vlerë sesa ajo e tenderuar në çdo ofertë të caktuar.

Neni 35

Në periudhën pas përfundimit të afatit për pranimin e ofertave për

pjesëmarrje në ankand, deri në përfundimin e afatit të mbajtjes së ankandit, të përcaktuar në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore, emetuesi aderon në sistemin elektronik, ndërsa kryen aprovimin e rezultateve të ankandit të letrave shtetërore me vlerë dhe njofton agjentin.

Neni 36

Rezultatet e ankandit përmbajnë oferta të suksesshme dhe/ose të pasuksesshme.

Ofertat e pranuar do të realizohen sipas kushteve të ofruara dhe në përputhje me rezultatet e ankandit.

Të gjitha ofertat e ankandëve të papranuara janë pa pasoja për emetuesin.

Neni 37

Pas aprovimit (autorizimit) të rezultateve të ankandëve të letrave shtetërore me vlerë nga emetuesi, rezultatet e ankandëve të letrave shtetërore me vlerë, agjenti i publikon nëpërmjet sistemit elektronik.

Çdo pjesëmarrës i autorizuar direkt, nëpërmjet sistemit elektronik ka qasje në rezultatet e veta në ankand, ku përfshihen:

- Vlerat e ofertave të suksesshme dhe çmimet me të cilat realizohen ofertat e suksesshme dhe
- Vlerat e ofertave të pasuksesshme dhe çmimet e tyre.

Neni 38

Gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, përveç rezultateve në sistemin elektronik, pjesëmarrësit e autorizuar direkt, njoftohen edhe mbi ofertat e suksesshme nga emetuesi, gjatë ditës së njëjtë të punës ose më së voni deri në orën 12 të ditës së ardhshme të punës.

Neni 39

Nëpërmjet sistemit elektronik, të gjithë pjesëmarrësit e autorizuar direkt kanë qasje në rezultatet e përgjithshme të ankandëve.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, pjesëmarrësit e autorizuar direkt informohen mbi rezultatet e ankandit dhe për vlerat e shpërndara të pjesëmarrësve indirekt, nëpërmjet raporteve përmbledhëse të shkëmbyera në mënyrë elektronike, me ç'rast ndërlidhja e ofertës me shpërndarjen kryhet nëpërmjet numrit identifikues (numri ID) në pajtim me nenin 20 paragrafi (2) e kësaj rregulloreje.

Neni 40

Në rast të tenderit me çmime të shumëfishta, rezultatet e përgjithshme të ankandit, përfshijnë të dhëna të ofertës, kërkesës dhe vlerës së përgjithshme të realizuar, çmimit të ponderuar (mesatar) të ankandit (normën e interesit), si dhe çmimit minimal dhe maksimal (norma e interesit) e ofertave të suksesshme.

Çmimi i ponderuar (norma e interesit) përlogaritet sipas formulës:

$$\text{Formula e ponderuar e çmimit (norma e interesit)} = \frac{\sum_{i=1}^n P_i * A_i}{\sum_{i=1}^n A_i}$$

P=çmimi (norma e interesit) e ofertës së suksesshme

A=vlera nominale e ofertës së suksesshme

n=numri i ofertave.

Neni 41

Në rast të tenderit me çmim të njëshuar, rezultatet e përgjithshme të ankandit përfshijnë të dhëna të ofertës, kërkesës dhe vlerës së përgjithshme të realizuar, çmimit të ponderuar (mesatar) të ankandit (normën e interesit), çmimit maksimal (norma minimale e interesit), si dhe çmimit minimal (normën maksimale të interesit), me ç'rast realizohen të gjitha ofertat e suksesshme.

Neni 42

Në rast të tenderit sipas vlerave, rezultatet e përgjithshme të ankandit përfshijnë të dhëna të ofertës, kërkesës dhe vlerës së përgjithshme të realizuar.

Neni 43

Pas pranimit të rezultateve të ankandit të letrave shtetërore me vlerë nëpërmjet sistemit elektronik, pjesëmarrësit e autorizuar direkt, deri në fund të ditës së punës, pjesëmarrësit indirekt i informojnë në mënyrë adekuate mbi rezultatet individuale dhe të përgjithshme të ankandit të letrave shtetërore me vlerë.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në rast të ankandit të emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, për të cilat, emetuesi në prospekt ka përcaktuar se pjesëmarrësit e autorizuar direkt duhet ta zbatojnë nenin 49 të kësaj rregulloreje, atëherë, ata mund t'i njoftojnë pjesëmarrësit indirekt mbi rezultatet individuale dhe/ose mbi rezultatet e përgjithshme të ankandit të letrave shtetërore me vlerë, ditën e ardhshme nga dita e pranimit të rezultateve nëpërmjet sistemit elektronik dhe/ose pranimit nëpërmjet raporteve përmbledhëse të shkëmbyera në mënyrë elektronike me emetuesin/agentin në pajtim me nenin 39 paragrafi (2) e kësaj rregulloreje.

1.4 Rihapje e ankandeve të letrave shtetërore me vlerë

Neni 44

Emetuesi, mund të realizojë rihapje të ankandeve të mbajtura të letrave shtetërore me vlerë të pamaturuara, ku për këtë e njofton agentin.

Rihapja e ankandeve të mbajtura do të ketë të njëjtat karakteristika me ankandin fillestar.

Emetuesi dhe agjenti në mënyrë adekuate i njoftojnë pjesëmarrësit e autorizuar direkt dhe pjesëmarrësit indirekt mbi kohën e rihapjes së ankandit.

1.5 Ankande të jashtëzakonshme të letrave shtetërore me vlerë

Neni 45

Emetuesi mund të zbatojë ankande të jashtëzakonshme të letrave shtetërore me vlerë dhe për këtë e njofton agjentin. Ankandi i jakshtëzakonshëm ka karakteristika të njëjta me ankandin e rregullt, me ndryshimin se pjesëmarrësit nuk janë të informuar paraprakisht në kalendar për ditën e mbajtjes së tij.

Emetuesi dhe agjenti në mënyrë adekuate i informojnë pjesëmarrësit e autorizuar direkt dhe pjesëmarrësit indirekt rreth kohës së mbajtjes së ankandit të jashtëzakonshëm.

1.6 Monitorimi i ankandit të letrave shtetërore me vlerë

Neni 46

Ankandet e letrave shtetërore me vlerë monitorohen prej emetuesit.

Monitorimi i ankandit përfshin:

- zbatimin e “rregullit të pjesëmarrjes së kufizuar” për ankande të caktuara;
- zbatimin e çmimit minimal - normës maksimale të interesit;
- hyrjen e paautorizuar në bazën e të dhënave të sistemit elektronik;
- sjelljet jolejale të pjesëmarrësve në ankand dhe përjashtimin eventuale nga ankandet;
- problemet eventuale teknike dhe vendosjen e ofertave në sistemin elektronik dhe
- anulimi i ankandit si rezultat i arritjes së marrëveshjes paraprake mbi çmimet nga ana e pjesëmarrësve.

“Rregulli i pjesëmarrjes së kufizuar” nga paragrafi (2) i këtij neni, për aq kohë sa zbatohet, publikohet në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.

Në rast të zbatimit të “rregullit të pjesëmarrjes së kufizuar”, çdo pjesëmarrës indirekt individual mund të marrë pjesë në ankandin e letrave shtetërore me vlerë vetëm nëpërmjet një pjesëmarrësi të autorizuar direkt.

Çmimi minimal - norma maksimale e interesit nga paragrafi (2) i këtij neni, për aq kohë sa zbatohet, publikohet në prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore në vend të pikës së përqindjes spekulative.

Neni 47

Në rast se nevojitet kohë shtesë për vendimmarrje, atëherë, emetuesi e njofton agjentin mbi ndryshimin e planit të terminit të procesit të ankandit.

2. Regjistrimi i letrave shtetërore me vlerë

Neni 48

Të dhënat e ofertave të suksesshme të letrave shtetërore me vlerë nga pjesëmarrësit e autorizuar direkt në emrin dhe llogarinë e tyre, përfshihen automatikisht në sistemin elektronik dhe nuk ka nevojë të vendosen në mënyrë shtesë.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt, deri në fund të ditës së mbajtjes së ankandit, në sistemin elektronik, vendosin të dhënat e pjesëmarrësve indirekt me oferta të suksesshme, për çdo letër me vlerë me shenjën përkatëse ISIN. Këto të dhëna përfshijnë:

- numrin amë të personit juridik, përkatësisht NVAQ -në (numrin e pasaportës - për jorezidentë) e personit fizik të poseduesit të letrave shtetërore me vlerë;
- emërtimin (e personit juridik) dhe emrin dhe mbiemrin (e personit fizik);
- shtetësinë;
- adresën;
- selinë (e personit juridik) ose vendbanimin (e personit fizik);
- shtetin;
- llogarinë bankare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me 15 karaktere;
- vlerën nominale të letrave shtetërore me vlerë të ndara dhe
- çmimin (në tenderin me çmime të shumëfishta).

Nëse pjesëmarrësi i autorizuar direkt nuk vendos të dhëna për pjesëmarrësit indirekt me oferta të suksesshme deri në fund të ditës së mbajtjes së ankandit, letrat shtetërore me vlerë i transferohen pjesëmarrësit të autorizuar direkt, i cili duhet ta paguajë vlerën e letrave shtetërore me vlerë të transferuara.

Paragrafi (3) i këtij neni nuk i referohet rasteve me probleme teknike të sistemit elektronik, kur pjesëmarrësi i autorizuar direkt mund t'i vendosë të dhënat për pjesëmarrësit indirekt me oferta të suksesshme, më së voni në orën 09:00 të ditës së ardhshme të ankandit.

Nëse poseduesi i letrave shtetërore me vlerë vendos ta ndryshojë llogarinë bankare të regjistruar fillimisht, në të cilën duhet të paguhet vlera nominale e bonove shtetërore, përkatësisht, vlera nominale dhe/ose interesi i kuponit të fletobligacioneve shtetërore, duhet të bëjë njoftimin me shkrim në regjistrat, më së voni se dy ditë pune, para datës së maturimit.

Neni 49

Me përjashtim të nenit 48 të kësaj rregulloreje, gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, pjesëmarrësit e autorizuar direkt, ditën e ardhshme të punës, nga dita e shpalljes së rezultateve të ankandit, më së voni deri në orën 14:00, duhet t'ia dorëzojnë emetuesit në mënyrë elektronike të dhënat e ofertave të suksesshme të letrave shtetërore me vlerë nga pjesëmarrësit e autorizuar direkt, në emrin dhe llogarinë e tyre, të cilat përfshihen në sistemin elektronik, si dhe të dhënat e pjesëmarrësve indirekt me oferta të

suksesshme, të cilat përfshihen në sistemin elektronik dhe/ose nëpërmjet raporteve përmbledhëse të shkëmbyera në mënyrë elektronike me emetuesin dhe agjentin për çdo letër me vlerë, me shenjë përkatëse ISIN. Këto të dhëna përfshijnë:

- numrin amë të personit juridik, gjegjësisht NVAQ-në (numrin e pasaportës - për jorezidentë) e personit fizik të poseduesit të letrave shtetërore me vlerë;
- emërtimin (e personit juridik) dhe emrin dhe mbiemrin (e personit fizik);
- shtetësinë;
- adresën;
- selinë (e personit juridik) ose vendbanimin (e personit fizik);
- shtetin;
- llogarinë bankare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me 15 karaktere;
- vlerën nominale të letrave shtetërore me vlerë të ndara dhe
- çmimin (në tenderin me çmime të shumëfishta).

Neni 50

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt, ditën e ardhshme të punës, pas ditës së mbajtjes së ankandit të bonove shtetërore (T+1) deri në orën 12:00, e kryejnë pagesën e vlerës së bonove shtetërore të blera në llogarinë e emetuesit.

Pjesëmarrësit e autorizuar direkt, dy ditë pune pas ditës së mbajtjes së ankandit të fletobligacioneve shtetërore (T+2) deri në orën 12:00, e kryejnë pagesën e vlerës së fletobligacioneve shtetërore të blera në llogarinë e emetuesit.

Vlera e paguar e letrave shtetërore me vlerë të blera në llogarinë e tyre dhe të dikujt tjetër, përkatësisht paguhet me 2 urdhërpagesa.

Formula e vlerës që paguhet:

$$I = P * A$$

I= vlera që duhet të paguhet

P=çmimi i ofertës së suksesshme

A=vlera nominale e ofertës së suksesshme.

Neni 51

Me përjashtim të nenit 50 të kësaj rregulloreje, gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, emetuesi mund të përcaktojë një numër tjetër ditësh për pagesën e bonove shtetërore dhe fletobligacioneve shtetërore, të cilat duhet të specifikohen në prospekt.

Neni 52

Emetuesi verifikon vlerat e paguara të letrave shtetërore me vlerë në ankand.

Nëse pas përfundimit të kohës nga neni 50 paragrafët (1) dhe (2) dhe neni 51 të kësaj rregulloreje, pagesa nuk është realizuar, agjenti, me urdhëresë së emetuesit, debiton llogarinë e pagesës së pjesëmarrësit të autorizuar direkt për vlerën e papaguar, sipas Autorizimit për debitim automatik të llogarisë së dhënë nga pjesëmarrësi i autorizuar direkt te agjenti në Formularin nr. 4 nga Rregulla e Sistemit të pagesave ndërbankare të Maqedonisë.

Nëse, nga ana tjetër, pjesëmarrësi i autorizuar paguan vlerë më të madhe mjetesh sesa vlera që duhet të paguhet, emetuesi kthen tepicën e vlerës së paguar, më së voni deri në orën 13:00.

Neni 53

Deri në orën 13:00, emetuesi përmes sistemit elektronik autorizon agjentin që të dorëzojë në regjistër të dhënat për poseduesit e letrave shtetërore me vlerë të paguara.

Neni 54

Agjenti i dorëzon të dhënat për poseduesit e letrave shtetërore me vlerë të paguara, në regjistër në mënyrë elektronike deri në orën 14:00.

Neni 55

Me përjashtim të neneve 53 dhe 54 të kësaj rregulloreje, gjatë emetimit të letrave shtetërore me vlerë me emërtim specifik, emetuesi i dorëzon të dhënat nga neni 49 të kësaj rregulloreje, të siguruara nga pjesëmarrësit e autorizuar direkt si raport përmbledhës në mënyrë elektronike në regjistër për të njëjtën ditë pune.

Neni 56

Letrat shtetërore me vlerë konsiderohen se janë emetuar me regjistrimin e tyre në llogaritë e poseduesve në regjistër.

Letrat shtetërore me vlerë në valutë vendase me ose pa klauzolë devizore mbahen në denarë në llogaritë e poseduesve në regjistër.

Në njoftimin e dorëzuar të poseduesit e letrave shtetërore me vlerë me klauzolë devizore, çeket vlera nominale e letrave shtetërore me vlerë e shprehur në denarë si dhe kursi mesatar devizor në valutë të huaj të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që vlen në ditën e ankandit.

Poseduesit e letrave shtetërore me vlerë mund të tregtojnë letra shtetërore me vlerë në tregun sekondar, më së voni dy ditë para ditës së maturimit të përcaktuar në prospekt.

Çdo ndryshim sa i përket posedimit të letrave shtetërore me vlerë regjistrohet në Librin e poseduesve të letrave shtetërore me vlerë nga ana e Regjistrimit.

IV. PAGESA E LETRAVE SHETËRORE ME VLERË

Neni 57

Letrat shtetërore me vlerë maturohen në ditën e përcaktuar në

prospektin e ankandit të bonove shtetërore dhe/ose në prospektin e ankandit të fletobligacioneve shtetërore.

Neni 58

Regjistri e paraqet Librin e letrave shtetërore me vlerë/të dhënat e pagesës së kuponit për agjentin dhe/ose emetuesin në mënyrë elektronike ose ndonjë mënyrë tjetër: një ditë pune para ditës së maturimit të vlerës nominale/kuponit të letrave shtetërore me vlerë menjëherë pas përfundimit të nivelizimit (shlyerjes) të transaksioneve tregtare të realizuara me Bursën e Maqedonisë së Letrave me Vlerë.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, nëse dita e dorëzimit të vlerës nominale/kuponit të letrave shtetërore me vlerë është ditë jo pune, të dhënat dorëzohen në ditën e parë vijuese të punës

Neni 59

Emetuesi, gjatë ditës së dorëzimit, u paguan bankave kuponin dhe/ose vlerën nominale të letrave shtetërore me vlerë të maturuara për poseduesit e regjistruar në regjistër një ditë pune para ditës së maturimit.

Pagesa e kuponit dhe/ose vlerës nominale të letrave shtetërore të maturuara në valutë vendase me klauzolë devizore realizohet në ditën e maturimit në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të valutës së huaj nga lista e kursit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut që vlen një ditë pune para ditës së pagesës.

Pagesa e vlerës nominale të letrave shtetërore me vlerë të maturuara me klauzolë devizore realizohet sipas formulës së mëposhtme:

$$I = \frac{n * 10.000 * dk_1}{dk}$$

I = Vlera e pagesës së kryegjësë

n = numri i letrave shtetërore me vlerë,

dk = kursi devizor në valutë të huaj që vlen në ditën e ankandit dhe

dk₁ = kursi devizor në valutë të huaj që vlen një ditë pune para ditës së pagesës.

Pagesa e kuponit të fletobligacioneve shtetërore me klauzolë devizore bëhet sipas formulës së mëposhtme:

$$C = \left[\frac{N * \frac{c}{t}}{dk} \right] * dk_1$$

Pagesa e kuponit të fletobligacioneve shtetërore me klauzolë devizore në rast se periudha për të cilën paguhet interesi i kuponit është e ndryshme nga periudha standarde e llogaritjes së kuponit, do të zbatohet formula vijuese:

$$C = \frac{\left(N * \frac{c}{t} * \frac{A}{e} \right) * dk_1}{dk}$$

N=kryegjëja,
 c=interesi vjetor i kuponit (%),
 t= numri i kuponave në nivel vjetor
 A=numri i ditëve nga fillimi i periudhës deri në ditën e nivelizimit,
 e=numri i ditëve gjatë periudhës së kuponit, në të cilën ndodh nivelizimi,
 dk = kursi devizor në valut të huaj që vlen ditën e ankandit dhe
 dk₁ = kursi devizor në valut të huaj që vlen një ditë pune para ditës së pagesës.

Pagesa e vlerës nominale të letrave shtetërore realizohet ndaj bankave ditën e maturimit deri në orën 10:00, ndërsa bankat vënë në dispozicion mjetet e paguara për poseduesit e letrave shtetërore me vlerë deri në orën 11:00, respektivisht ditën e njëjtë.

Pagesa e kuponit të maturuar të letrave shtetërore me vlerë realizohet ndaj bankave ditën e maturimit deri në orën 13:00, ndërsa bankat vënë në dispozicion mjetet e paguara për poseduesit e letrave shtetërore me vlerë deri në orën 14:00, respektivisht ditën e njëjtë.

Nëse detyrimi për pagesë nuk përmbushet si rezultat i llogarisë së paraqitur gabimisht ose jo të paraqitur, nga pjesëmarrësi i autorizuar direkt në regjistër, emetuesi kryen pagesën vetëm pas marrjes së llogarisë së saktë.

Neni 60

Mjetet për pagesën e kuponit të maturuar dhe/ose të vlerës nominale të letrave shtetërore me vlerë, në rast të procedurës së ngritur të falimentimit, likuidimit, si dhe kufizimit të një pjese ose të gjitha operacioneve bankare në bankë, nëpërmjet së cilës do të duhet të realizohet pagesa, emetuesi dorëzon për pagesë nëpërmjet një bankeje tjetër.

Në rastet e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni, poseduesit e letrave shtetërore me vlerë kanë si detyrim, jo më vonë se dy ditë pune përpara maturimit të kuponit dhe/ose vlerës nominale të letrave shtetërore me vlerë, ta njoftojnë regjistrin për llogarinë e ndonjë banke tjetër në të cilën emetuesi duhet të bëjë pagesën.

V. LISTIMI I FLETOBLIGACIONEVE SHETËRORE

Neni 61

Fletobligacionet e emetuara shtetërore listohen në Bursën e Maqedonisë në pajtim me rregullativën e listimit, si dhe në tregjet tjera financiare.

VI. ANULIMI I ANKANDIT DHE SHTYRJA E PAGESËS SË DETYRIMEVE TË MATURUARA PËR LETRAT SHTETËRORE ME VLERË

Neni 62

Anulimi i ankandit dhe shtyrja e pagesës së detyrimeve të maturuara për letrat shtetërore me vlerë mund të ndodhë për shkak të:

- ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike;
- jofunksionimit të pajisjeve dhe serverëve të komunikimit dhe
- veprimit të forcës madhore (vis major) dhe rrethanave të tjera të jashtëzakonshme.

Në rast të ndonjë rreziku nga paragrafi (1) i këtij neni, ankandi i letrave shtetërore me vlerë anulohet. Për datën dhe orën e mbajtjes së ankandit të radhës së letrave shtetërore me vlerë, emetuesi nëpërmjet agjentit informon në mënyrë shtesë pjesëmarrësit e autorizuar direkt.

Në rast të ndonjë rreziku nga paragrafi (1) i këtij neni, pagesa e letrave shtetërore me vlerë shtyhet përkohësisht. Për datën dhe kohën e pagesës, emetuesi informon në mënyrë shtesë pjesëmarrësit e autorizuar direkt.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 63

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e emetimit dhe pagesës së letrave shtetërore me vlerë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.99/05, 35/07, 132/07, 68/09 dhe 131/09").

Neni 64

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.

Ministër i Financave
Dr. Fatmir Besimi

Shkup